

UDHËZIM
Nr. 3, datë 7.2.2014

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 60, DATË 26.12.2013, “PËR ZHVILLIMIN E
PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2014”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 26 të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 8.2.2006, “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe provimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)”,

UDHËZOJ:

1. Pika 1 e udhëzimit nr. 60, datë 26.12.2013, “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore” ndryshon si më poshtë:

“1.1 Testi i gjuhës së huaj të hartohet në përputhje me gjuhën, e cila në planin mësimor të shkollës së mesme të lartë trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor A2.

1.2 Menyja e gjuhëve të huaja si provim i detyruar është: anglisht, italisht, frëngjisht, gjermanisht.

1.3 Teksti i gjuhës së huaj si provim i detyruar do të hartohet nga AKP-ja dhe provimi do të administrohet dhe vlerësohet nga DAR/ZA-të përkatëse”.

2. Germa “c” e pikës 3 ndryshon si më poshtë:

“c) Maturanti ka të drejtë të zgjedhë gjuhën e huaj, të cilën parapëlqen, pavarësisht nëse e ka zhvilluar ose jo në shkollë, në nivelin gjuhësor B2. Lista e gjuhëve si lëndë me zgjedhje të detyruar përcaktohen në udhëzimin për plotësimin e formularit A1/A1Z.”

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri: Sekretari i Përgjithshëm, Komiteti i Maturës Shtetërore, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Arsimore dhe Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla